



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR**  
**Drejtoria e Buxhetit Financës dhe Investimeve**

Nr. Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2015

**DREJTUAR:**            **Ministrisë së Financave**  
                         **Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit**  
                         **Drejtorisë së Analizave dhe Politikave Buxhetore**

**LENDA:**                **Mbi raportet e monitorimit për periudhën**  
                                 **janar - dhjetor 2014**

Në mbështetje të ligjit nr.185/2013 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr.3/1 datë 17.01.2014 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2014", po ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për pushtetin gjyqësor, sipas programeve buxhetore të miratuara për periudhën janar - dhjetor 2014.

**Programi - "Buxheti Gjyqësor"**

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2014-2016. Ky program konsiston në mbështetjen buxhetore të shërbimeve gjyqësore dhe përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, me qëllim sjelljen e tyre në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e Bashkimit Europian. Buxheti i alokuar në këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim kryesor arritjen e standarteve bashkohore në shërbimin gjyqësor nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës ndërtimore dhe elektronike të gjykatave, të cilat krijojnë kushte optimale pune dhe sigurie për gjyqtarët dhe stafin mbështetës si dhe zhvillimin e proçeseve gjyqësore dhe shërbimet e tjera ndaj publikut me cilësi dhe transparencë.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

**Formati nr. 7 - Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën janar - dhjetor 2014.**

Me Ligjin Nr.185/2013, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014", fondet e akorduara për funksionimin e aktivitetit të gjykatave, sipas artikujve, paraqiten në vijim.

## **1-Shpenzime Personeli**

Fondi i akorduar për periudhën janar - dhjetor për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 1,570,000 mijë lekë. Buxheti i rishikuar është 1,502,065 mijë lekë dhe realizimi paraqitet në masën 1,394,914 mijë lekë ose 89% e buxhetit të detajuar dhe 93% ndaj buxhetit të rishikuar.

Gjatë periudhës janar-dhjetor, gjykatat nuk kanë përdorur të plotë fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, për shkak të mosplotësimit të strukturave organike.

Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2014, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë kësaj periudhe. Ka patur mungesa në mesatarisht 61 punonjës nga të cilat 26 administratë dhe 35 gjyqtarë të pa emëruar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Konkretisht, ka patur mungesa në strukturat organike në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apeleve Durrës, Shkodër, Tiranë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Dibër, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kurbin, Pogradec, Përmet, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykatat Administrative Gjirokastrë, Korçë, Shkodër .

Me ligjin e buxhetit për vitin 2014, u miratua rritje e numrit të punonjësve për pushtetin gjyqësor, me 94 punonjës. Ky numër kishte të bënte me nevojën për 11 punonjës të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, 28 ndihmës ligjorë për gjykatat administrative si dhe 55 punonjës administrate për gjykatat administrative dhe gjykatat e tjera. Një pjesë e numrit shtesë, u detajua nga Ministria e Drejtësisë, me miratimin e strukturave të reja organike, në muajin mars. Ndërkohë mbeti i padetajuar numri shtesë i miratuar për 28 ndihmës ligjorë të gjykatave administrative, për shkak të mplotësimit të kuadrit ligjor për procedurat e marrjes në punë dhe pagesën e tyre.

Marrë në konsideratë fondin e lirë të krijuar gjatë vitit, për shkak të mungesave në strukturat organike të gjykatave, si dhe nevojat emergjente të gjykatave administrative dhe gjykatave të tjera për buxhet shtesë në shpenzime operative, i kërkua Ministrisë së Financave transferimin e fondit të lire, 30 milion lekë nga “Paga” në “Shpenzime operative”. Ministri i Financave, bazuar në argumentat e paraqitura, me shkresën nr.7360/1, datë 20.05.2014, miratoi këtë transferim, duke e çelur këtë buxhet tek Z.A.B.GJ. në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor, i cili më pas u transferua për tu përdorur nga gjykatat.

Gjithashtu një pjesë e fondit të lirë të krijuar në shpenzime personeli, në vlerë 32,138 mijë lekë, u pakësua me Aktin Normativ nr. 1 datë 17.09.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013 datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”.

Këto rialokime ndikuan në realizimin në masën 93% ndaj buxhetit të rishikuar për shpenzime personeli për vitin 2013.

## **2-Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën janar - dhjetor është 332,820 mijë lekë, ndërsa buxheti i rishikuar është 391,251 mijë lekë. Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 377,685 mijë lekë ose 97% e buxhetit të rishikuar dhe 113% ndaj buxhetit të detajuar në fillim të vitit.

Buxheti i miratuar në fillim të vitit 2014, ishte i pamjaftueshëm për mbështetjen e plotë të aktivitetit vjetor të gjykatave dhe shlyerjen e detyrimeve të mbartura nga viti 2013. Për këtë arsye, sikurse u përmend më sipër, gjatë vitit, në negociata me Ministrinë e Financave, u realizua transferimi i fondeve të papërdorura, nga pagat në shpenzime operative.

Nga ana tjetër, në kuadër të Strategjisë “Për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe plani i veprimit”, gjatë vitit 2014 u akordua një buxhet shtesë në vlerë rreth 17 milion lekë, me të cilin u bë e mundur shlyerja e të gjithë detyrimeve të prapambetura të gjykatave për ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe një pjesë tjetër të detyrimeve të prapambetura në zërin shpenzime operative. .

Me gjithë fondet shtesë të akorduara në kuadër të strategjisë, gjykatat kanë ende detyrime të mbartura të deklaruara në Ministrinë e Financave në vlerë rreth 9 milion lekë, për të cilat, sipas strategjisë të miratuar nga Këshilli i Ministrave, do të akordohet buxhet i veçantë shtesë gjatë vitit të 2015.

Përveç fondeve të miratuara nga buxheti i shtetit, gjatë vitit 2014, gjykatat kanë përdorur edhe të ardhurat e krijuara nga tarifatat e shërbimeve gjyqësore, sipas udhëzimit të përbashkët të Kryetarit të Bordit Drejtues të Zyrës dhe Ministrit të Financave, nr 1 datë 08.03.2013 ”Për përdorimin e të ardhurave të krijuara nga tarifatat e shërbimeve të administratës gjyqësore”.

Për periudhën janar- dhjetor 2014, gjykatat kanë përdorur rreth 48,477 mijë lekë (23,847 mijë lekë në shpenzime operative dhe 24,630 lekë në investime). Përdorimi i 10% të të ardhurave nga tarifatat e shërbimeve gjyqësore ka patur impakt pozitiv në aktivitetin e gjykatave. Kështu të ardhurat e përdorura në artikullin 602 ”Shpenzime operartive” kanë ndikuar në shlyerjen në masë të konsiderueshme të nevojave të gjykatave për pagesat për avokatët e thirrur kryesisht, shpenzime postare si dhe nevojave të tjera të paraqitura gjatë këtij viti. Nga ana tjetër, një pjesë e këtyre të ardhurave është përdorur edhe për investime, ku do te veçonim investimin e kryer nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për rikonstruksionin e godinës së KESH-it, transferuar me vendim të këshillit të ministrave për këtë gjykatë. Ky investim do të shtrihet në dy vite 2014-2015 dhe parashikohet të shtojë në godinën civile të gjykatës midis të tjerave 13 salla gjykimi, duke përmirësuar ndjeshëm procesin e zhvillimit të çështjeve gjyqësore në sallat e gjyqit, në respektim të soleminitetit të gjykimit.

### 3-Investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit është 139,843 në mijë lekë, ndërsa realizimi 136,754 mijë lekë ose 98% .

në mijë/lekë

Projekti	Plan	Fakt	%
1 . Ndertim	43,130	42,678	99%
2 . Rikonstruksion	34,753	33,760	97%
3 . Pajisje - Mobilje	55,040	53,674	98%
4 . Automjet	6,000	5,997	100%
5 . Projekt	920	645	70%
<b>TOTALI</b>	<b>139,843</b>	<b>136,754</b>	<b>98%</b>

## “Ndërtim”

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në projektin “Ndërtim” për periudhën janar-dhjetor është 43,130 mijë lekë, kurse realizimi 42,678 mijë lekë ose 99%. Ky fond u detajua për fillimin e zbatimit të punimeve për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Apelit Shkodër. Ndërtimi i godinës është parashikuar të shtrihet në tre vite 2014-2016. Gjykata ka realizuar të plota likujdimet sipas punimeve të kryera për vitin 2014.

## “Rikonstruksion”

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në projektin “ Rikonstruksion” për periudhën janar-dhjetor është 34,753 mijë lekë dhe realizimi 33,760 mijë lekë ose 97%. Ky fond u detajua për realizimin e rikonstruksioneve të plota dhe të pjesshme në 10 gjykata: Gjykatën e Apelit Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, Dibër, Lushnjë, Tropojë, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Vlorë.

Si rezultat i investimeve të kryera u realizua:

- 1- Rikonstruksion i pjesshëm i godinës, për Gjykatën e Apelit Durrës. Si rezultat i këtij investimi u bë i mundur shtimi i ambjenteve të nevojshme të punës për gjyqtarët e shtuar në organikë, si dhe krijimi i një sallë gjyqi shtesë. Buxheti i detajuar për këtë objekt është 10,844 mije leke, kurse realizimi është 10,817 mijë lekë.
- 2- Investimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për krijimin e ambjentit të shërbimit për publikun dhe aksesin për personat me aftësi të kufizuar. Buxheti i detajuar për këtë objekt është 8,500 mije leke, kurse realizimi është 8,225 mijë lekë.
- 3- Financimi i fillimit të punimeve për rikonstruksionin e godinës së KESH-it, kaluar me vendim qeverie për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kontrata e lidhur nga gjykata për realizimin e këtij investimi është rreth 30 milion lekë. Për vitin 2014, u detajua nga buxheti i shtetit fondi 7.2 milion lekë. Një pjesë e këtij investimi në vlerë rreth 17 milion lekë, është mbuluar nga të ardhurat e realizuara nga gjykata për vitin 2014. Pjesa e mbetur, do të mbulohet nga të ardhurat që gjykata parashikon të realizojë për vitin 2015. Ky investim parashikohet të shtojë në godinën civile të gjykatës midis të tjerave 13 salla, duke përmirësuar ndjeshëm procesin e zhvillimit të çështjeve gjyqësore në sallat e gjyqit, në respektim të soleminitetit të gjykimit.
- 4- Ndërhyrje të vogla në disa gjykata me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe krijimin e disa standarteve të nevojshme të munguara në to dhe konkretisht në :
  - Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, për përmirësimin e elementëve të sigurisë në gjykatë.
  - Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me qëllim zgjerimin e arkivës, krijimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuar si dhe përmirësimin e ambjentit të shërbimit për publikun.
  - Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër dhe Tropojë për kryerjen e punimeve që kanë të bëjnë me hidroizolim të tarracës.
  - Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës për përshtatjen e ambjenteve të Zyrës Vendore të Përmbartimit Durrës, ku është vendosur gjykata. Ky investim ka bërë të mundur akomodimin e gjyqtarëve dhe stafit administrativ të gjykatës.
  - Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për krijimin e ambjentit të shërbimit të publikut të munguar për gjykatën.

## **"Paisje Mobilje"**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2014 në projektin "Pajisje Mobilje" është 55,040 mijë lekë dhe realizimi 53,674 mijë lekë ose 98%. Ky fond është prokuruar për blerjen e paisjeve sipas grupeve të mëposhtme:

**Paisje elektronike.** Fondi i akorduar është 36,057 mijë lekë, ndërsa realizimi 35,184 mijë lekë ose 98%. Mospërdorimi i plotë i këtij fondi është rrjedhojë e diferencave të krijuara nga procedurat e prokurimit. Ky buxhet u përdor për pajisjen e 36 gjykatave me paisje elektronike si: kompjutera, printera, monitore, UPS, rack serveri etj.

**Paisje sigurie.** Fondi i akorduar është 1,571 mijë lekë, ndërsa realizimi 1,531 mijë lekë, ose 97%. Mospërdorimi i të gjithë fondit të detajuar për këtë projekt, është rrjedhojë e diferencave të krijuara nga procedurat e prokurimit. Si rezultat i fondit të prokuruar, u bë e mundur paisja e gjykatave me kamera vëzhguese, aparat dore për kontrollin e armëve dhe sistem alarmi.

**Mobilje .** Fondi i akorduar është 13,315 mijë lekë, ndërsa realizimi është në masën 12,894 mijë lekë, ose 97%. Si rezultat i fondit të prokuruar, 19 gjykata u paisjen me mobilje për zyra për gjyqtarët dhe administratën, sallat e gjyqit, etj.

**Paisje të tjera.** Fondi i akorduar për 12/mujorin është 4,097 mijë lekë, ndërsa realizimi është 4,064 mijë lekë ose 99%. Ky fond është prokuruar në 9 gjykata, të cilat me fondin e vënë në dispozicion realizuan plotësimin e nevojave për disa paisje të cilat nuk përfshihen në grupimet e mësipërme si: gjenerator, grila, paisje kundra zjarrit, aparate telefoni, central etj.

## **"Projekt".**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për këtë zë të investimeve është 920 mijë lekë, ndërsa realizimi është 645 mijë lekë ose 70%. Mospërdorimi i të gjithë fondit të detajuar për këtë projekt, është rrjedhojë e diferencave të krijuara nga procedurat e prokurimit.

Me fondin në dispozicion u realizua pagesa e plotë për hartimin e projektit për rikonstrukcionin e pjesshëm të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe likuidimin në masën 60% të projektit për përshtatjen e ish godinës së KESH-it dhe zgjerimin e sipërfaqes së punës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë

## **"Automjet".**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për këtë zë të investimeve është 6,000 mijë lekë, ndërsa realizimi është 5,997 mijë lekë, ose 100%. Ky buxhet u detajua për Gjykatën e Lartë për blerjen e tre autoveturave. Gjykata ka përfunduar procesin e prokurimit dhe likuidimit.

## **Formati nr.8 - Raporti i shpenzimeve sipas Programeve**

Buxheti i detajuar për periudhën janar- dhjetor 2014, në fillim të vitit për këtë program është 2,041,990 mijë lekë dhe realizimi 1,912,517 mijë lekë ose 94 %.

Në terma konkrete, janë realizuar të plota shpenzimet e parashikuara në këtë program, për shpenzime operative dhe investime. Realizimi në nivel programi, në masën 94%, vjen për shkak të mospërdorimit të plotë të fondit për shpenzime personeli, si rezultat i mungesave në strukturat organike të gjykatave, siç u shpjegua më sipër.

### **Formati nr.9 - Raporti i Realizimit të Produkteve të Programit**

Programi “Buxheti Gjyqësor” për periudhën janar - dhjetor 2014, përbëhet nga disa produkte, të cilat janë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP). Në funksion të objektivit të parë të DPP-se, janë përcaktuar disa produkte, realizimi sasior i të cilëve paraqitet si më poshtë:

#### **Produkti A “Çështje të gjykuara në vit” - Njësia matëse nr.çështjesh.**

Numri i çështjeve të parashikuara për periudhën janar-dhjetor 2014 është 152,149. Ky parashikim është kryer nga gjykatat, referuar tendencës së numrit të çështjeve për disa vite. Për këtë periudhë janë gjykuar plotësisht 144,732 çështje dhe janë në proces për t’u gjykuar 7,417 çështje. Në realizimin sasior të këtij produkti ka ndikuar mosplotësimi i strukturave organike në disa gjykata. Por, duhet të merret në konsideratë edhe fakti që në realizimin e çështjeve gjyqësore ndikojnë edhe një sërë faktorësh të tjerë proceduriale apo substanciale që paraqiten specifike për çdo çështje.

#### **Produkti B- “Sipërfaqe godine e re” - Njësia matëse m<sup>2</sup>.**

Në këtë produkt është për periudhën janar - dhjetor është parashikuar të realizohet 668 m<sup>2</sup> sipërfaqe godine e re, kurse është realizuar 678 m<sup>2</sup>. Ky produkt është realizuar plotësisht. Realizim vjen për shkak të rialokimit në muajin dhjetor të një fondi shtesë, brenda vlerës së kontratës së lidhur për këtë qëllim.

#### **Produkti D - “Projekt zbatim për rikonstruksion të plotë të godinave të gjykatave”. Njësia matëse nr. institucioni.**

Ky produkt nuk është realizuar plotësisht, sepse Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, nuk mundi ta përdorë fondin, i cili u transferuar nga Ministria e Financave në muajin tetor, për disa nevoja të tjera të paraqitura nga gjykatat. Në këtë produkt është parashikuar projekt për hartimin e projektit për rikonstruksionin e pjeshëm të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe likuidimin në masën 60% të projektit për përshtatjen e ish godinës së KESH-it dhe zgjerimin e sipërfaqes së punës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë

#### **Produkti E- “Sipërfaqe godine e rikonstruktuar” - Njësia matëse m<sup>2</sup>.**

Në këtë produkt për periudhën janar-dhjetor është parashikuar të realizohet 592 m<sup>2</sup> sipërfaqe godine e rikonstruktuar, ndërkohë që është realizuar 550 m<sup>2</sup>. Parashikimi është bërë për ofrimin e këtij produkti në 11 gjykata, ndërkohë që është realizuar në 10 prej tyre. Nuk u realizua ky produkt në 3 gjykata si : Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, për të cilat buxheti i miratuar në fillim të vitit është transferuar nga Ministria e Financave për nevoja të tjera të paraqitura nga gjykatat në investime. Si rezultat i rialokimit të fondeve gjatë vitit u realizua ky produkt në dy gjykata shtesë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Tropojë të parashikuara në fillim të vitit.

**Produkti F** “Mobilje për zyra dhe salla gjyqi për gjykatat ” - Njësia matëse nr. institucioni.

Në këtë produkt për periudhën janar - dhjetor është parashikuar realizimi i mobiljeve për zyra dhe salla gjyqi, për 15 institucione dhe konkretisht është realizuar në 19 institucione. Katër gjykata, kanë prokuruar produktin “F”, nëpërmjet buxhetit shtesë të alokuar për këtë qëllim.

**Produkti G** -“Elementë sigurie për gjykatat”- Njësia matëse nr. institucioni.

Ky produkt është realizuar plotësisht në 4 institucione. Në këtë produkt bëjnë pjesë Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, të cilat kanë prokuruar sistem alarmi, kamera vëzhgimi, aparat për kontrollin e armëve si dhe Gjykata e Apelit Tiranë e Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, të cilat kanë prokuruar për emergjence për paisje sigurie.

**Produkti H** -“Paisje të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatave”- Njësia matëse nr. Institucioni.

Në këtë produkt është parashikuar realizimi i paisjeve të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatës në 4 gjykata dhe është realizuar në 9 gjykata. Pesë gjykata, për arsye të domosdoshmërisë për paisje të tjera, kanë realizuar këtë produkt nëpërmjet ndryshimit në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike.

**Produkti I** -“Automjete për gjykatat”- Njësia matëse nr.automjete

Në këtë produkt është parashikuar blerja e tre autoveture për Gjykatën e Lartë. Ky produkt është realizuar plotësisht.

Në funksion të objektivit të dytë të DPP-se, është përcaktuar nje produkt, realizimi sasior i të cilit paraqitet si më poshtë:

**Produkti K** -“Paisje elektronike për gjykatat”- Njësia matëse për këtë produkt “nr.institucioni”.

Në këtë produkt është parashikuar realizimi i paisjeve elektronike në 35 institucione dhe është realizuar në 35 institucione. Ky produkt është realizuar plotësisht.

Në funksion të objektivit të tretë të DPP-se, janë përcaktuar 2 produkte, realizimi sasior i tyre paraqitet si më poshtë:

**Produkti L** “Gjyqtare të trajnuar për anën profesionale të tyre” - Njësia matëse “nr.gjyqtarësh”.

Në këtë produkt për periudhën 12/mujore është parashikuar mbështetja me buxhet për shpenzime udhëtim e dieta për trajnimin profesional të 87 gjyqtarëve nga Shkolla e Magjistraturës, ndërkohë që janë realizuar trajnime për 84 gjyqtarë. Për këtë produkt shpjegojmë se trajnimet janë kryer nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të detyrimit ligjor që ka ky institucion.

**Produkti M** -“ Konferencë Gjyqësore Kombëtare” - Njësia matëse nr.konference.

Në këtë produkt është parashikuar realizimi i Konferencës Gjyqësore Kombëtare, produkt i cili është realizuar plotësisht për vitin 2014.

#### **Formati nr.10- Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Produkteve**

Programi i parë “Buxheti Gjyqësor” për periudhën janar-dhjetor 2014 përbëhet nga disa produkte të cilat janë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP). Në funksion të objektivit të parë të DPP-së, janë përcaktuar disa produkte, realizimi vleror i të cilëve paraqitet si më poshtë:

**Produkti A** - “Çështje të gjykuara në vit”.

Buxheti për këtë produkt për periudhën janar-dhjetor 2014, është planifikuar në shumën 1,897,479 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,770,773 mijë lekë ose 93%.

Sikurse u shpjegua në raportin e realizimit të shpenzimeve sipas artikujve dhe programit, realizimi në këtë masë, vjen për të njëjtin shkak, mosplotësimin e strukturave organike të gjykatave gjatë vitit.

**Produkti B** - “Sipërfaqe godine e re”

Në këtë produkt është planifikuar të realizohet ndërtimi i godinës së re, në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ndërtimi i godinës është parashikuar të shtrihet në tre vite 2014-2016 dhe fondi i miratuar për vitin 2014 është 42.000 mijë lekë. Gjykata ka realizuar të plota likujdimet sipas punimeve të kryera për vitin 2014.

**Produkti D** - “Projekt zbatim për rikonstrukcion të plotë të godinave të gjykatave”.

Në këtë produkt për periudhën janar- dhjetor është parashikuar një buxhet në vlerën 2,300 mijë lekë, ndërsa realizimi është 645 mijë lekë. Ky realizim vjen nga fondi i përdorur për likujdimin e 60% të projektit për përshtatjen e ish godinës së KESH-it dhe zgjerimin e sipërfaqes së punës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe për realizimin e projektit për rikonstrukcionin e pjesshëm të godinës të gjykatës të Apelit Durrës.

Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, nuk mundi të realizojë prokurimin e fondit të detajuar për të, fond i cili u rialokua për nevoja të gjykatave te tjera.

**Produkti E**- “Sipërfaqe godinë e rikonstruktuar”

Buxheti për këtë produkt për periudhën janar-dhjetor është 33,660 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 33,759 mijë lekë ose 100%.

Ky fond u realizua në 10 gjykata konkretisht: Gjykatën e Apelit Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, Dibër, Lushnjë, Tropojë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Vlorë.



Tre gjykata nuk mundën të realizojnë këtë produkt, për të cilat shpjegojmë si më poshtë:

- Për Gjykatën e Apelit Vlorë, u detajua fondi 700 mijë lekë për kryerjen e punimeve, për përshtatjen e ambjenteve dhe krijimin e zyrave për 2 gjyqtarët shtesë në organikë. Ky fond nuk u prokuruar nga gjykata pasi nuk u bë i mundur kalimi i këtyre ambjenteve. Në muajin Tetor u realizua transferimi i tij për nevoja të tjera të paraqitura nga gjykata.
- Për Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, për periudhën janar-dhjetor u detajua fondi në vlerën 8,000 mijë lekë. Fillimisht u parashikua rikonstrukcioni i godinës ekzistuese të gjykatës. Më pas, për shkak të pamjaftueshmërisë së ambjenteve, nga gjykata në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, u bë e mundur sigurimi i një godine tjetër për t'u rikonstruktuar dhe përshtatur për nevoja të gjykatës (godina e ish- Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme të Tiranës). Me një pjesë të fondeve në dispozicion për vitin 2014, do të realizohej hartimi i projektit teknik. Procedura e prokurimit për hartimin e projekt zbatimit nuk u realizua dot për shkak të mungesës së konkurrencës. Duke qenë se koha e mbetur deri në fund të vitit 2014, ishte e pamjaftueshme për realizimin e saj, ky proces do të finalizohet në pjesën e parë të vitit 2015. Në këto kushte, fondi i miratuar për këtë gjykatë u transferua nga Ministria e Financave në muajin Tetor për nevoja të gjykatave të tjera në investime.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, u detajua fondi 450 mijë lekë, për krijimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuar. Për shkak të pamundësisë së realizimit të këtij investimi, ky fond është transferuar nga Ministria e Financave në muajin Tetor, për disa nevoja të tjera të paraqitura nga kjo gjykatë.

Gjithashtu në këtë rezultat ka ndikuar riallokimi i kryer gjatë vitit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Tropojë, të cilat sipas shpejgimeve të dhëna edhe më sipër, kanë realizuar plotësisht buxhetin e miratuar. Këto dy gjykata nuk kanë qenë të parashikuara në fillim të vitit 2014.

**Produkti F-** “Mobilje për zyra dhe salla gjyqi për gjykatat”.

Buxheti për këtë produkt është 13,110 mijë lekë, kurse realizimi paraqitet në masën 12,894 mijë lekë, ose 98%.

**Produkti G** -“Elementë sigurie për gjykatat”.

Buxheti për këtë produkt për periudhën janar - dhjetor është 1,350 mijë lekë, kurse realizimi paraqitet në masën 1,531 mijë lekë, ose 113%. Në realizimin e këtij produkti ka ndikuar realizimi i prokurimeve me fonde shtesë, për të cilat nuk është detajuar buxhet në fillim të vitit.

**Produkti H** -“Paisje të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatave”.

Për këtë produkt është parashikuar buxhet për periudhën janar - dhjetor në vlerën 3,290 mijë lekë, kurse realizimi paraqitet në masën 4,064 mijë lekë. Edhe për këtë produkt ka ndikuar realizimi i prokurimeve me fonde shtesë, për të cilat nuk ishte detajuar buxhet në fillim të vitit.

### **Produkti I - "Automjete për gjykatat"**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për këtë produkt është 6,000 mijë lekë, ndërsa realizimi është 5,998 mijë lekë, ose 100%. Ky buxhet u detajua për Gjykatën e Lartë për blerjen e tre autoveturave. Gjykata ka realizuar plotësisht produktin.

Në funksion të objektivit të dytë të DPP-se, është përcaktuar një produkt, realizimi vleror i të cilit paraqitet si më poshtë:

### **Produkti K - "Paisje elektronike për gjykatat".**

Buxheti për periudhën janar- dhjetor për këtë produkt është 37,460 mijë lekë, ndërsa është realizuar 35,184 mijë lekë, ose 94%. Ky produkt është realizuar plotësisht.

Në funksion të objektivit të tretë të DPP-se, janë përcaktuar 2 produkte, realizimi i tyre paraqitet si më poshtë:

**Produkti L- "Gjyqtarë të trajnuar për anën profesionale të tyre".** Ky produkt për periudhën janar - dhjetor është parashikuar në masën 3,341 mijë lekë, ndërkohë që është realizuar në vlerën prej 3,048 mijë lekë, ose 91%.

### **Produkti M- "Konferencë Gjyqësore Kombëtare".**

Për këtë produkt u parashikuar buxhet për periudhën janar - dhjetor në vlerën 2,000 mijë lekë, ndërkohë që është realizuar në vlerën prej 1,943 mijë lekë, ose 97%. Produkti është realizuar plotësisht.

### **Programi- "Planifikim menaxhim dhe administrim "**

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP). Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP; harmonizimi i nevojave të gjykatave me burimet financiare në dispozicion për pushtetin gjyqësor, në funksion të mbështetjes së shërbimeve gjyqësore, përmirësimit tërësor të infrastrukturës së gjykatave për realizimin e proceseve gjyqësore dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut. Kjo politikë ka si qëllim kryesor, menaxhimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore, që miratohen për Pushtetin Gjyqësor për të siguruar pavaresinë financiare të Gjyqësorit .

### **Formati nr. 7 - Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën janar - dhjetor 2014.**

Me Ligjin Nr.185/2013, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014", Zyrës të Administrimit të Buxhetit Gjyqësor i janë akorduar fondet, sipas artikujve si më poshtë:

#### **1.Shpenzime Personeli**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit si dhe buxheti i rishikuar për periudhën janar - dhjetor, për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 23,500 mijë lekë, kurse

realizimi është 19,493 mijë lekë ose 83% e buxhetit të detajuar dhe të rishikuar. Ky realizim vjen nga mosplotësimi i strukturës së ZABGJ-së me dy punonjës.

## **2.Shpenzime për Mallra dhe Sherbime të Tjera**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën janar-dhjetor për vitin 2014 është 4,700 mijë lekë. Buxheti i rishikuar është 4,668 mijë lekë. Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 4,430 mijë lekë, ose 94% ndaj buxhetit të planifikuar, si dhe 95% të buxhetit të rishikuar.

## **3.Investime**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në fillim të vitit, për periudhën janar - dhjetor është 830 mijë lekë. Ndërkohë, me Aktin Normativ nr.1, datë 17.09.2014 dhe shkresën e Ministrisë të Financve nr.13955/1 datë 14.10.2014, për ZABGJ u miratua një fond shtesë në investime në vlerën 11,539 mijë lekë, përkatësisht 4,039 mijë lekë për blerje paisje elektronike (program financiar) dhe 7,500 mijë lekë për blerjen e 3 automjete për nevojat e gjykatave. Realizimi është në vlerën 11,826 mijë lekë.

**Paisje mobilje.** Fondi i akorduar në fillim të vitit, për periudhën janar-dhjetor është 830 mijë lekë, buxheti i rishikuar me aktin normativ është 4,869 mijë lekë ndërsa realizimi 4,407 mijë. Si rezultat i fondit të prokuruar, u bë e mundur zhvillimi i një projekti pilot për paisjen e 10 gjykatave dhe ZABGJ me programin financiar, që do të shërbejë për dixhitalizimin e aktivitetit financiar në gjykata dhe ZABGJ. Ky program do të ketë efekt të drejtëpërdrejtë në menaxhimin e buxhetit dhe veprimeve financiare që kryhen nga gjykatat; menaxhimin e aseteve dhe minimizimin e riskut në përdorimin e tyre, menaxhimin e të dhënave personale të punonjësve; ndjekjen dhe kontrollin në kohë të çdo veprimi financiar dhe buxhetor të gjykatave nga Zyra; monitorim të realizimit të objektivave buxhetor dhe ligjshmërisë së veprimeve financiare të gjykatave etj.

**Automjet .** Realizimi i projektit është 7,420 mijë lekë, Me fondin shtesë në masën 7,500 mijë lekë u realizua blerja e tre automjeteve për nevojat që gjykatat kanë në fushën e transportit.

## **Formati nr.8 - Raporti i shpenzimeve sipas Programeve**

Fondi i detajuar për këtë program për periudhën janar-dhjetor 2014, është 29,210 mijë lekë dhe realizimi 35,836 mijë lekë. Ky program përbëhet nga tre produkte:

**Produkti A-** “Buxhet vjetor për Pushtetin Gjyqësor i administruar në mënyre efçente dhe efektive”.

Në funksion të realizimit të këtij produkti shërben i gjithë buxheti i detajuar për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative. Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën janar - dhjetor 28,380 mijë lekë dhe realizimi 24,010 mijë lekë ose 85%. Realizimi në këtë përqindje është rrjedhojë e mospërdorimit të plotë të fondit për “Shpenzime personeli” për arsyet e sipërpërmendura.

**Produkti B-** “Paisje elektronike për zyra për ZABGJ”

Në këtë produkt periudhën janar- dhjetor është parashikuar në fillim të vitit, një buxhet në vlerë 480 mijë lekë dhe buxheti i rishikuar me aktin normativ dhe ndryshimet në regjistër është 4,869 mijë lekë. Produkti është realizuar plotësisht në vlerën 4,407 mijë lekë.

**Produkti C-** “Mobilje për zyra për ZABGJ”

Në këtë produkt për periudhën janar- dhjetor ishte parashikuar një buxhet në vlerën 350 mijë lekë, për Zyrën e Adminstrimit të Buxhetit Gjyqësor për plotësimin e nevojave për mobilje. Ky fond me ndryshim në rregjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, u transferua në produktin B “Paisje elektronike për zyra për ZABGJ”.

**Produkti I** -“Automjete për gjykatat”

Me buxhetin e miratuar në fillim të vitit 2014, nuk u detajua buxhet për këtë produkt. Ndërkohë, sikurse u përmend më sipër, me Aktin Normativ nr.1, datë 17.09.2014 dhe shkresën e Ministrisë të Financve nr.13955/1 datë 14.10.2014, u miratua një fond shtesë në vlerë 7,500 mijë lekë për blerjen e 3 automjete për nevojat e gjykatave. Ky produkt është realizuar plotësisht në vlerën 7,420 mijë lekë.

**DREJTORE**

**Luljeta LAZE**

